

RRETHANAT POLITIKE DHE SHOQËRORE TË SHQIPTARËVE NË MAQEDONI NË FILLIM TË REFORMAVE TË TANZIMATIT

THE POLITICAL AND SOCIAL CIRCUMSTANCES OF THE ALBANIANS IN MACEDONIA AT THE BEGINNING OF THE TANZIMAT REFORMS

Hasan SALIU¹, Zejni MAZLLAMI²

¹Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

²Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: hasan.saliu@unite.edu.mk, zejni.mazllami@unite.edu.mk

Abstract

The continuous weakening of the Ottoman Empire had convinced the leadership of the necessity of a deep reform in all areas, from the army to the civil administration. Despite unfavorable circumstances, the opposition of many quarters and difficulties in implementation, the reform project known as Tanzimat was crowned in 1839. With the new reforms, Christians were exempted from paying the jizya (tax), in exchange for this was their participation in the army and administration. In the second half of the 18th century, the Pasha of Tetovo was created, administered by Koxha Rexhep Pasha. In 1842, after an open conflict between the descendants of Koxha Rexhep Pasha, Abdurahman Pasha, Havzi Pasha and Hasan Pasha, Sultan Abdul Mejidi took advantage of it to remove the Tetovo pashas, who owned very large wealth, from the government in Tetovo, Skopje and Kystendil. The end of the Tetovo pashas also marked the beginning of a major uprising known in historiography as the Dervish Cara Uprising.

Keywords: Ottoman Empire, Albanians in Macedonia, Tanzimat, Pashalik of Tetovo.

Abstrakt

Dobësimi i vazhdueshëm i Perandorisë Osmane kishte bindur udhëheqësinë për domosdoshmerinë e një reforme të thellë në të gjitha fushat, nga ushtria deri te administrata civile. Pavarësisht rrethanave të pavolitshme, kundërshtimit të shumë qarqeve dhe vështirësive në zbatim projekti i reformave i njohur si Tanzimat u kurorëzua në vitin 1839. Me reformat e reja, të krishterët u përjashtuan nga pagesa e xhizjes (xhizja), në këmbim të kësaj ishte pjesëmarrja e tyre në ushtri dhe administratë. Në pjesën e dytë të shekullit XVIII ishte krijuar Pashallëku i Tetovës që administrohej nga Koxha Rexhep Pasha. Në vitin 1842, pas një konflikti të hapur midis pasardhësve të Koxha Rexhep Pashës, Abdurahman Pasha, Havzi Pasha dhe Hasan Pasha, sulltan Abdul Mexhidi e shfrytëzoi për të larguar nga qeverisja në Tetovë, Shkup dhe Qystendil pashallarët e Tetovës, të cilët zotëronin pasuri shumë të madhe. Fundi i pashallarëve të Tetovës shënoi edhe fillimin e një kryengritje të madhe e njohur në historiografi si Kryengritja e Dervish Carës.

Fjalë kyçe: Perandoria Osmane, Shqiptarët në Maqedoni, Tanzimati, Pashallëku i Tetovës.

Pasqyrë e shkurtër rreth reformave të Tanzimatit

Krizat e brendshme dhe kërcënimet e jashtme rriten bindjen te udhëheqësia osmane se vetëm një reformë e thellë do ta ndihmonte Perandorinë Osmane që t'i përballonte. Në tre dekadat e para të shekullit XIX, Konventa e Akermanit (tetor 1826), Traktati i Edrenesë (1828-1829), pavarësia e Greqisë, autonomia e Serbisë, rebelimi dhe konflikti i hapur me Mehmed Aliun në vitet 1831-1841, treguan qartë dobësinë e Perandorisë Osmane¹.

¹ Charles Jelavich & Barbara Jelavich. *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit*, Tiranë, 2004, 97.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p3135>

Reformat e para të centralizuara osmane u quajtën të pamjaftueshme, kështu që nevojitej një ndryshim më i thellë, ky ndryshim i thellë mund të bëhej nga Mustafa Reşid Pasha (1800-1858), i cili kishte përvojë në vendet perëndimore. Periudha më domethënëse në historinë e Perandorisë Osmane të shekullit XIX është e periudha e Tanzimatit. Pavarësisht literaturës dhe burimeve të shumta për studimin e saj, ajo vazhdon të jetë tërheqëse dhe komplekse për historianët.

Ndër ndryshimet më domethënëse ishin ato që kishin të bënin me ligjet që siguronin të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët (pavarësisht besimit fetar), me qëllim që Perandoria Osmane të bëhej një shtet modern. Ideja e një bote të ndryshme nuk lindi brenda Perandorisë, por në botën e jashtme, nëpërmjet kontakteve që kishin ata që udhëtonin ose jetonin jashtë kufijve të saj. Në shekullin XIX, Perandoria Osmane nuk ishte një fuqi që përbënte kërcënim për Evropën, por një shtet që u bë një fushë konkurrence për dominim nga fuqitë evropiane në territoret e saj².

Periudha e reformave në Perandorinë Osmane filloi gjatë mbretërimit të Sulltan Selimit III, i cili sundoi nga viti 1781 deri në vitin 1807. Ai vlerësoi se Perandoria kishte nevojë për reformë ushtarake, por për shkak të luftërave që Perandoria Osmane po zhvillonte me Austrinë dhe Rusinë, këto plane duhej të shtyeshin. Reformat, sidomos ushtarake filluan të shfaqen gjatë sundimit të sulltan Mahmudit II (1808-1839), kurse lulëzuan dhe morën formën e vërtetë gjatë periudhës së Tanzimatit (1839-1876). Sulltan Mahmudi II fillimisht u mundua që t'i bind jeniçerët, që ishin kundërshtarë kryesor të reformës ushtarake duke u premtuar grada të larta në hierarkinë e re ushtarake dhe duke u lejuar atyre të martoheshin dhe të kishin pronë personale. Në vitin 1826, korpusi i jeniçerëve u shpërbë me dhunë dhe u prezantua një sistem i ri ushtarak Nizam-i cedit, njësoj si në vendet e Evropës Perëndimore, që ishte vazhdimësi e ideve dhe përpjekjeve të mëhershme të Sulltan Selimit III për të krijuar një ushtri moderne në stilin evropian³.

Zbatimi i kësaj reforme ushtarake kërkonte mbajtja e një ushtrie të rregullt, e cila kërkonte një administratë financiare që mbështetej në një sistem modern të centralizuar financimi⁴. Sulltan Mahmudi II synonte që të bëjë reforma në të gjitha fushat e jetës shtetërore, për këtë qëllim ai thirri Mustafa Reshid Pashën. Diplomati i lartë osman, falë dijes së gjerë dhe përvojës së gjatë përpunoi planet për reformat e ardhshme gjithëpërfshirëse. Sulltani më 3 nëntor 1839 lëshoi një dekret për zbatimin e këtyre reformave. Këto reforma në historiografi si Tanzimat (Tanzimât)⁵. Gjatë periudhës së Tanzimatit, u miratuan reforma ekonomike, administrative dhe sociale, sistemi financiar u riorganizua sipas modelit francez.

Përmes dekreteve të veçanta u themeluan universitetet dhe akademitë e para moderne. Në mënyrë që qytetarët e zakonshëm të mos i ndienin fare përfitimet e reformave, atyre iu shtuan taksa të reja që ishin të nevojshme për të zbatuar reformat e reja. Meshkujt muslimanë ishin të detyruar të kryejnë shërbim të rregullt ushtarak⁶.

Grupi i atyre që kundërshtonin reformat e reja ishte i shumtë sidomos në mesin e popullatës muslimane e udhëhequr nga bejlerët, pashallët dhe ulematë. Me reformat e reja, të krishterët u përjashtuan nga pagesa e xhizjes (taksës për siguri), në këmbim të së cilës merrnin pjesë në ushtri dhe administratë⁷.

Kuadrot tradicionale dhe fetare të Perandorisë Osmane u zëvendësuan nga kuadro të reja me origjinë të ndryshme. Për këtë arsye, institucionet e reja arsimore moderne dhe laike të krijuara gjatë periudhës së Tanzimatit miratuan këtë strukturë të re shtetërore. Barazia nënkuptonte

² Илбер Ортајли, *Најдолгиот еек на империјата*, Скопје, 2009, 23.

³ Арон Давыдович Новичев, *История Турции. Вторая часть, Новое время (1839-1853)*, Ленинград, 1973, 110

⁴ И. Ортајли, *Најдолгиот еек на империјата*, 49

⁵ Douglas A. Howard, *A History of the Ottoman Empire*, Cambridge University Press, Cambridge, 2017, 371.

⁶ Stanford Shaw & Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, v. II, Cambridge, 1977, 95.

⁷ Bernard Lewis, *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, Ankara, 1993, 116.

barazi detyrimesh dhe shërbim ushtarak për të gjithë, ligjet mbi veshjet u shfuqizuan pothuajse plotësisht dhe gjykatat fetare mbetën thuajse jashtë funksionit të tyre⁸.

Pashallëku i Tetovës në gjysmën e parë të shekullit XIX

Paraardhësit e Dervish Shalës ishin nga rrethi i Shkodrës, ishin të krishterë që u vendosën në fshatin Bitaj në rajonin e Lumës. Gjergj Bib Shala pranoi fenë islame dhe u pagëzua me emrin mysliman Dervish Shala, nga kjo martesë lindën tre djem: Hasani, Osmani dhe Mustafa. Hasan Shala pati mundësinë të shkollonte djalin e tij Rexhepin në Akademinë Ushtarake në Stamboll, ku mori gradën ushtarake të oficerit dhe ishte pjesëmarrës në Luftën Austro-Osmane, ku u gradua në titullin Pasha dhe u emërua Pasha i Tetovës, sepse në fillim të shekullit XVIII u formua Pashallëku i Tetovës⁹.

Rexhep Pasha, për shkak të aftësive të tij në fushën e betejës u dërgua në Bagdad për të qetësuar trazirat, atje humbi jetën. Djali i tij Hasan Pasha pasi erdhi në krye të Pashallëkut të Tetovës, u angazhua për rregullimin dhe përparimin e këtij Pashallëku. Pas vdekjes së Hasan Pashës, i cili nuk la trashëgimtar filluan trazirat në Pashallëkun e Tetovës, këto trazira u qetësuan kur sulltani emëroi për pasha nipin e tij të quajtur sipas babait të tij, Rexhep Pasha. Për meritat e tij u emërua Koxha Rexhep Pasha ose Rexhep Pasha i Madh¹⁰.

Koxha Rexhep Pasha në krye të Pashallëkut të Tetovës përmendet për herë të parë në vitin 1770, me rastin e pjesëmarrjes së tij në luftërat e Perandorisë Osmane. Pashallëku i Tetovës për më shumë se gjysmë shekulli u administrua nga Koxha Rexhep Pasha, i cili e zgjeroi Pashallëkun duke ia bashkangjitur Nahijen e Gostivarit, e cila administrohej nga Delibash Topal-beu¹¹.

Në vitin 1787, lindi një konflikt midis Koxha Rexhep Pashës dhe Mahmut Pashë Bushatliut të Shkodrës, dhe pas këtij konflikti, një pjesë e zonave të Pashallëkut të Tetovës që ndodheshin deri në Prizren u morën nga Mahmut Pashë Bushatliu. Marrëdhëniet ndërmjet pashallarëve të Tetovës dhe pashallarëve të Shkodrës u përmirësuan¹².

Koxha Rexhepa Pasha, sipas urdhrit të Sulltanit, mori pjesë në shtypjen e Kryengritjes së Parë Serbe me njësitin e tij ushtarak. Për nevojat e ushtrisë, gjyqësorit, arsimit dhe nevojave të tjera, Pashallëku i Tetovës, falë të ardhurave të shumta të mbledhura në taksa, ndërtoi disa ndërtesa brenda Pashallëkut, dhe veçanërisht në qendër të Pashallëkut në Tetovë, u riparuan dhe u rinovuan disa ndërtesa ekzistuese, etj. Nga ajo kohë, ndër të tjera, duhet përmendur Kalaja e Tetovës, në vitin 1796 filloi të ndërrohet në vendin strategjik Baltepe mbi mbetjet e një kalaje të vjetër¹³.

Në vitin 1822, Koxha Rexhep Pasha u pasua nga djali i tij i madh, Abdurahman Pasha. Për të zgjeruar pashallëkun, Abdurahman Pasha dërgoi Veli Beun me një regjiment ushtarak për të nënshtruar Kërçovën dhe zonën përreth, që administrohej nga Qorr Beu. Në vitin 1824, pati trazira në Thesali dhe në pjesë të tjera të Greqisë, vëlla i Abdurahman Pashës, Havzi Beu, shkoi në Larisa dhe tregoi rezultate të shkëlqyeshme, për sukseset e tij në luftërat kundër kryengritësve grekë, Havzi Beu u dekorua nga Sulltani dhe u emërua Pasha i Sanxhakut të Shkupit, kurse vëllai tjetër i Abdurahman Pashës, Hasan Beu, u emërua Pasha i Sanxhakut të Qystendilit¹⁴.

Gjatë Luftës Ruso-Osmane të vitit 1829, marrëdhëniet midis pashallëqeve të Tetovës dhe Shkodrës u ftohën për shkak të qëndrimit të Mustafa Pashë Bushatit ndaj asaj lufte. Por kjo situatë zgjati për pak kohë dhe marrëdhëniet mes tyre u përmirësuan shpejt. Kjo konfirmohet

⁸ Donald Quataert, *The Ottoman Empire 1700–1922*, Cambridge, 2005, 178.

⁹ Хаџи Васиљевић, Јов, *По Тетовској области*, Београд, 1938, 12-13.

¹⁰ Nadi Bilmenoğlu, Nadi. *Kalkandelen Dün ve Bugün, İstanbul*, 1975, 65-67

¹¹ А. М. Селищев. *Полог и его болгарское население*, София, 1929, 91.

¹² Stavri N. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës në vitet e para të shek XIX, 1796-1831*, Tiranë, 1986, 89.

¹³ Ештреф Емини & Лубен Лапе, *Тетово и Тетовско низ историјата*, Скопје, 1982, 208-216.

¹⁴ N. Bilmenoğlu, *Kalkandelen Dün ve Bugün*, 73-74.

nga ndihmesa e pashallarëve të Tetovës në konfliktin e vitit 1831 të Mustafa Pashë Bushatit kundër Portës së Lartë¹⁵.

Me zbatimin e Hatisherifit të Gjylhanesë, filloi rezistenca kundër reformave, ndonëse u dhanë disa të drejta për jomuslimanët por u vendosën detyrime të rënda që nuk kishin ekzistuar më parë, siç ishte rekrutimi ushtarak. Sapo fillonte zbatimi i reformës në ndonjë provincë, menjëherë shpërthenin kryengritjet pikërisht në ato provinca ku filluan të zbatoheshin reformat e Tanzimatit¹⁶.

Rezistenca ndaj rekrutimit ushtarak ishte veçanërisht e fortë në Ballkan, ku deri atëherë nuk i ishin nënshtruar rekrutimit ushtarak. Nga ana tjetër, zbatimi i rekrutimit ushtarak ishte në shumë aspekte në kundërshtim me botëkuptimin, zakonet dhe privilegjet e tyre të vjetra. Pashallarët ishin të zënë midis dy zjarreve nën presionin e pushtetit osman, i cili po përpiqej të mbledhte rekrutë ushtarakë, dhe nën presionin e njerëzve që nuk pranonin kryerjen e rekrutimit ushtarak. Për këto arsye, si dhe për shkak të interesave të tyre individuale, disa pashallarë iu përgjigjën hapur Portës së Lartë se nuk mund të dërgonin rekrutë ushtarakë, sepse popullsia në territoret e tyre po rezistonte. Por, pavarësisht rezistencës së tyre, qeveria osmane filloi rekrutimin ushtarak. U shfaqën edhe dezertimet e para. Zbatimi i reformave nënkuptonte shfuqizimin e qeverisjes së decentralizuar dhe gjysmë të pavarur të pashallarëve dhe bejlerëve të fuqishëm¹⁷. Pas vdekjes së Rexhep Pashës, pasardhësit e tij vazhduan besnikërinë ndaj sulltanit. Përveç Pashallëkut të Tetovës që administrohej nga Abdurahman Pasha, administrimi i vëllaut të tij Havzi Pashës, përveç Shkupit shtrihej edhe në Kumanovë, Koçani, Shtip, Kaçanik, Kratovë dhe një zonë të gjerë nga Velesi deri në Qystendil¹⁸.

Marrëdhëniet e mira midis tre vëllezërve me Portën e Lartë zgjatën deri në fund të vitit 1842, ku pati një konflikt të hapur midis tre vëllezërve: Abdurahman Pasha i Tetovës, Havzi Pasha i Shkupit dhe Hasan Pasha i Qystendilit. Ky ishte edhe momenti i volitshëm për sulltan Abdul Mexhidin që të marrë masa për të kufizuar pushtetin e pashallarëve të Tetovës, të cilët zotëronin pasuritë mëdha. Shkak i konfliktit besohet të këtë qënë ndarja e trashëgimisë, pasi Havzi Pasha dhe Hasan Pasha nuk ishin të kënaqur me trashëgiminë që u përkiste atyre në Pashallëkun e Tetovës¹⁹.

Sulltani i thirri tre vëllezërit pashallarë në Stamboll dhe u kërkoi të zbatonin reformat e Tanzimatit, duke kërkuar që të tre vëllezërit të dërgonin redifë. Pashallarët tetovarë refuzuan dhe sulltani urdhëroi menjëherë që Abdurahman Pasha dhe Hasan Pasha të internoheshin në Anadoll, ndërsa Havzi Pasha të burgosej²⁰.

Ndërsa lajmi për burgosjen e pashallarëve nga sulltani u përhap në Shkup, shqiptarët, nga hidhërimi, rrëmbyen armët dhe u ngritën kundër Portës së Lartë. Sulltani i bashkoi këta pashallëqe në një njësi administrative dhe emëroi Mehmed Jusuf Pashën me seli në Shkup. Pashallëku i Tetovës pushoi së ekzistuari si i pavarur. Kur Mehmed Jusuf Pasha u përpoq të kryente një regjistrim të redifëve, me qëllim që t'i dërgonte në Selanik, e gjithë popullata shqiptare e ish-pashallëqeve u bashkua dhe refuzoi kategorikisht të shkonte në ushtinë e rregullt. Ky rebelim i shqiptarëve në korrik 1843 e detyroi Mehmed Pashën dhe Hajredin Pashën të tërhiqnin urdhrin për mbledhjen e nizamëve. Por më pas ai dha përsëri urdhër për të mbledhur ushtarë të rregullt për Perandorinë Osmane²¹.

¹⁵ S. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës...*, 158.

¹⁶ Арон Давыдович Новичев, *Борьба между реформаторами и консерваторами в период Танзимата (1839-1853)*, Тюркологический Сборник, 1973, Москва, 1975, 95.

¹⁷ Арон Д. Новичев, *История Турции III : новое время, часть вторая (1839-1853)*, 132.

¹⁸ J. Хади Васиљевић, *По Тетовској области*, 12.

¹⁹ Стојан Новаковић, *Балканска питања, Београд, 1906*, 108

²⁰ Е. Емини & Л. Лапе. *Тетово и Тетовско низ историјата*, 235.

²¹ AShSh, *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912*, Tiranë 2002, 92.

Përfundim

Perandoria Osmane, pas luftërave me habsburgët dhe rusët dhe kryengritjeve të brendshme, kuptoi jo vetëm pafuqinë e saj ushtarake por edhe ngecjen e saj të përgjithshme, në një situatë të tillë reformat ishin nevojë urgjente. Procesi i reformave ishte i ngadalshëm dhe i vështirë, ai filloi që nga koha e Sulltan Selimit III, vazhdoi me Sulltan Mahmudin II për t'i përfunduar në fund të qeverisjes së Abdylmexhidit II. Reformat jo vetëm që nuk e kënaqen popullatën jomuslimane që e bënë të barabartë, por sollën kundërshtim edhe nga muslimanët që përveç humbjes së privilegjeve kishte detyrime të rënda dhe taksa të reja. Në fillim të shekullit XVIII u formua Pashallëku i Tetovës. Ky pashallëk fuqinë me të madhe do ta ariijë gjatë administrimit të Koxha Rexhep Pashës dhe Abdurrahman Pashës. Familja e pashallarëve të Tetovës do të shtrijë ndikimin e tyre edhe jashtë Tetovës, nga Shkupi deri në Qystendil.

Në vitin 842, sulltani shfrytëzoi konfliktin midis djemve të Rexhep Pashës për t'u çliruar nga pashallarët e pabindur. Masat e marra nga Porta e Lartë, përveçse nuk dhanë rezultate, ishin arsyeja e pakënaqësisë në rritje midis shqiptarëve dhe si rezultat, një vit më vonë, shpërtheu kryengritja e udhëhequr nga Dervish Cara.

Referencat

- [1]. AShSh, *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912*, Tiranë 2002.
- [2]. Charles Jelavich & Barbara Jelavich. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit*, Tiranë, 2004
- [3]. Илбер Ортајли, *Најдолгиот еек на империјата*, Скопје, 2009.
- [4]. Арон Давыдович Новичев, *История Турции III, Вторая часть, Новое время (1839-1853)*, Ленинград, 1973
- [5]. Howard, Douglas A. *A History of the Ottoman Empire*, Cambridge University Press, Cambridge, 2017
- [6]. Shaw, Stanford & Shaw, Ezel Kural. *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, vol. II, Cambridge, 1977
- [7]. Lewis, Bernard. *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, Ankara, 1993
- [8]. Quataert, Donald. *The Ottoman Empire 1700–1922*, Cambridge, 2005
- [9]. Хаџи Васиљевић, Јов, *По Тетовској области*, Београд, 1938, стр. 12-13.
- [10]. Bilmenoğlu, Nadi. *Kalkandelen Dün ve Bugün*, İstanbul, 1975, 65-67
- [11]. А. М. Селищев. *Полог и его болгарское население*, София, 1929
- [12]. Naçi, Stavri N. *Pashallëku i Shkodrës në vitet e para të shek XIX, 1796-1831*, Tiranë, 1986
- [13]. Емини, Ештреф & Лапе, Лубен. *Тетово и Тетовско низ историјата*, Скопје, 1982
- [14]. Новакович, Стојан. *Балканска питања*, Београд, 1906.